



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 746/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Jetmir Canolli, kandidat për anëtar i Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Jetmir Canolli, kandidat për anëtar i Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me shenjë ZL.Anr.746/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.746/2017 me datën 09.11.2017 në ora 15:40, nga parashtruesi Jetmir Canolli, kandidat për anëtar i Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, në të cilën pretendohet se në qendrat e votimit si: në VV 1024D/02R, VV 1001D/05D dhe VV1001D/02D ka mospërputhje të votave në mes të Formularëve të Rezultateve për Kandidatë-FRK dhe raportit të vëzhguesve që kanë të bëjnë me kandidatin në fjalë.

Parashtruesi i ankesës si provë nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankueses gjeti se ankues me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli ankesën e ankueses e konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.746/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Paneli
Gyltenë Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*